



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**PROJEKT VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_.\_\_.2025

**PËR**

**“KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE TË SISTEMIT TË INTEGRUAR MJEDISOR ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Integruar Mjedisor, këtu e në vijim SIM.
2. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore SIM është Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
3. Të dhënat e bazës së të dhënave shtetërore sipas pikës 1, të këtij vendimi, ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:
  - 3.1) të dhënat parësore konsiderohen të dhënat e mbledhura nga AKM-ja, që kanë të bëjnë me:
    - a. të dhënat shtesë që mblidhen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për lejet mjedisore, Vlerësimet e Ndikimit në Mjedis dhe licenca;
    - b. të dhënat për përdoruesit, si roli i tyre në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, sektori përkatës, niveli i aksesimit;
    - c. të dhënat për infomacionin financiar (tarifat vjetore për lejet e tipit A, B);
    - ç. të dhënat për raportet e vetëmonitorimit;
    - d. të dhënat për Regjistrin e Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (RSHTN);
    - dh. të dhënat për inventarin e Gazeve me efekt serrë;
    - e. regjistrin për operatorët e Substancave Ozonholluese, autorizimet e kuotave vjetore të importit e substancave ozonholluese dhe raportimin vjetor nga subjektet e licencuara dhe autorizuar për importin e substancave ozonholluese”;
    - ë. regjistrin e operatoreve të pajisur me kod unik për transferimin e mbetjeve;
    - f. informacionin mbi dëgjesat publike;
    - g. regjistri i transfertave të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme;
    - gj. të dhënat për regjistrin e menaxhimit të procesit të punës (ëorkfloë) të një leje/licence
    - h. regjistri i mbetjeve urbane për çdo bashk;
    - i. regjistri i të dhënave nga ministritë e linjës dhe doganat;
    - j. regjistri eksportit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme dhe tranzit të mbetjeve të rrezikshme dhe inerte;

- k. regjistri i autorizimeve per eksport dhe tranzit te mbetjeve;
  - l. Regjistri për sipërmarrësit e licencuar dhe autorizuar për importin e gazeve serrë të fluoruara dhe pajisjeve që funksionojnë me gaze serrë të fluoruara, autorizimet për pajisjen me kuotë vjetore importi, gjeneralitetet e personave që kryejnë shërbime me këto gaze, si dhe raportimet vjetor nga subjektet e licencuara dhe autorizuar;
  - ll. Regjistri për Monitorimin, Raportimin dhe Verifikimin e Shkarkimeve të Gazeve me Efekt Serrë (MRVA), i cili përfshin informacionin mbi autorizimet për shkarkimin e GES, planet e monitorimit, raportet vjetore të shkarkimeve nga verifikues të akredituar.
- 3.2) të dhënat dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga ndërveprimi me bazën e të dhënave shtetërore të Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit, bazën e të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (sistemi *e-Leje*), bazën e të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të *e-inspektimi* në Inspektoriatin Qendror, të dhënat gjeohapësinore për koordinatat dhe shapefiles për cdo leje/licencë nga ndërveprimi me sistemin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Regjistrin Elektronik të Kimikateve në *e-albania* të Zyrës së Kimikateve si dhe çdo bazë tjetër të dhënash, që mund të ndërveprojë me sistemin SIM dhe të jetë e regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

4. “Dhënës të informacionit”, në kuptim të këtij vendimi dhe në kuptim të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”, që kanë akses në bazën e të dhënave me të drejta sipas roleve përkatëse janë:

- a) subjektet, e pajisura me leje mjedisore, licenca dhe VNM;
- b) ministria përgjegjëse për mjedisin;
- c) Njësitë e Qeverisjes Vendore;
- ç) Doganat;
- d) Ministrinë e linjës ;
- dh) institucionet mbështetëse të cilat kontribuojnë me të dhënat dytësore sipas shkronjës "b", të pikës 3, të këtij vendimi;
- e) Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve

5. “Subjekte të interesuara”, në kuptim të këtij vendimi dhe të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”, të cilët kanë akses në bazën e të dhënave me të drejta sipas roleve përkatëse, janë:

- a) subjektet, e pajisura me leje mjedisore, licenca dhe VNM;
- b) Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencitë Rajonale;
- c) ministria përgjegjëse për mjedisin;
- ç) Njësitë e vetqeverisjes vendore;
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- dh) ministria përgjegjëse për shëndetësinë;
- e) ministria përgjegjëse për bujqësinë.

6. Të dhënat personale të transmetuara ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin janë grumbulluar.

7. Niveli i aksesimit në sistemin SIM bazohet në rolet e krijuara të përdoruesve si më poshtë:
- a) Sektori i shqyrtimit teknik për veprimtaritë në mjedis (leje mjedisore/licencat), në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:
    - i. shikon të dhënat dytësore të lejeve dhe licencave;
    - ii. shikon, krijon, të dhënat parësore për menaxhimin e procesit të punës (ëorkfloë) deri në përfundim të procesit.
  - b) Sektori i shqyrtimit teknik të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:
    - i. shikon të dhënat dytësore të regjistrit *e-lejet*;
    - ii. shikon, lexon te dhënat e delegimin të proceseve të punës (workflow);
    - iii. shikon, lexon Listën e aplikimeve hyrëse dhe ato të përfunduara, për t'u shkarkuar me një komandë;
    - iv. shikon, krijon, të dhënat parësore për menaxhimin e procesit të punës (ëorkfloë) deri në marrjen e vendimit.
  - c) Sektori i Monitorimit të lejeve mjedisore dhe VNM, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:
    - i. shikon të dhënat dytësore të lejeve mjedisore dhe VNM;
    - ii. shikon, të dhënat e vetëmonitorimit të hedhura nga subjektet;
    - iii. shikon, shkruan të dhënat e menaxhimit të procesit të punës (workflow).
  - ç) Sektori i asistencës dhe unifikimeve të proceseve mjedisore, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:
    - i. shikon të dhënat parësore të hedhura nga subjektet;
    - ii. shikon, krijon të dhënat e menaxhimit procesit të punës (ëorkfloë) deri në përfundim të procesit;
    - iii. shikon, shkruan, të dhënat parësore për informacionin mbi dëgjuesat publike.
  - d) Sektori i Menaxhimit të Kimikateve, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:
    - i. shikon të dhënat dytësore të lejeve mjedisore dhe licencave;
    - ii. shikon të dhënat parësore të vetëmonitorimit të hedhura nga subjektet;
    - iii. shikon të dhënat parësore për Regjistri i Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (RSHTN);
    - iv. shikon të dhënat parësore për regjistrin e kimikateve;
    - v. shikon të dhënat parësore për ozonhollueset;
    - vi. shikon të dhënat parësore për gazet serre;
  - dh) Sektori i informacionit, statistikave mjedisore dhe GIS, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:
    - i. shikon të dhënat dytësore të lejeve mjedisore, licencave dhe VNM;
    - ii. shikon të dhënat parësore të regjistrit të vetëmonitorimit;
    - iii. shikon të dhënat parësore të regjistrit të mbetjeve;
    - iv. shikon të dhënat parësore të regjistrit RSHTN;
    - v. shikon të dhënat parësore të regjistrit GS;
    - vi. shikon të dhënat parësore të regjistrit për Ozonhollueset;
    - vii. shikon të dhënat dytësore të regjistrit të sistemit gjeohapësinor të lejeve/licencave dhe VNM;
    - viii. shikon të dhënat parësore të regjistrit të Operatorëve të pajisur me kod unik për transferimin e mbetjeve;

- ix. shikon të dhënat dytësore të Informacionit mbi dëgjesat publike;
  - x. shikon të dhënat parësore të Regjistrit të transfertave të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme;
  - xi. të dhënat për regjistrin e menaxhimit të procesit të punës (ëorkfloë) të nje leje/licence.
  - xii. shikon të dhënat parësore të regjistrit të mbetjeve urbane për çdo qark;
  - xiii. shikon të dhënat parësore të regjistrit të të dhenave nga ministritë e linjës dhe doganat;
  - xiv. shikon të dhënat parësore të regjistrit të eksportit të mbetjeve;
  - xv. shikon të dhënat parësore për regjistrin e kimikateve;
- e) Sektori i Inspektimit të lejeve mjedisore dhe VNM, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:
- i. shikon të dhënat dytësore të lejeve mjedisore dhe VNM;
  - ii. shikon, lexon të dhënat në regjistrin e procesit të punës (workflow).
- ë) Sektori i financës, buxhetit, mbledhjes së tarifave dhe identifikimit të debitorëve, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit:
- i. shikon të dhenat dytësore të lejeve mjedisore dhe VNM;
  - ii. shikon, shkruan të dhënat parësore për informacionin financiar;
  - iii. shikon të dhënat në regjistrin e procesit të punës (workflow).
- f) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në ushtrim të funksionit të saj politikbërës dhe mbikëqyrës për politikat mjedisore, ka akses të plotë dhe funksional në të gjithë përmbajtjen e sistemit SIM, përfshirë të dhënat parësore dhe dytësore. Ministria është e pajisur me përdorues me profil të dedikuar për sektorin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, i cili ka:
- i. akses të plotë për të parë dhe shkarkuar të gjitha të dhënat parësore dhe dytësore që lidhen me aplikimet për VNM;
  - ii. mundësi për të ndjekur dhe analizuar proceset e shqyrtimit teknik dhe administrativ të VNM-ve;
  - iii. funksionalitet për të gjeneruar raporte të avancuara dhe statistika tematike, si dhe për të ndjekur tendencat dhe përputhshmërinë me politikat dhe strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare;
  - iv. të drejtën për t'u konsultuar për çdo përmirësim të sistemit SIM që prek fushën e VNM-së.
- g) Agjencitë Rajonale të Mjedisit:
- Çdo drejtori rajonale është e lidhur me një përdorues me rolin "ARM" dhe do të ndërveprojë si më poshtë:
- i. shikon të dhënat dytësore në regjistrin e lejeve/licencave dhe VNM;
  - ii. Shikon dhe shkruan të dhënat parësore në regjistrin e menaxhimit të procesit të punës (workflow) të një leje dhe VNM.
- gj) Subjekti i pajisura me leje mjedisore, licenca dhe VNM:
- i. shikon, krijon të dhënat parësore të regjistrit të vetëmonitorimit;
  - ii. shikon, krijon të dhënat parësore të regjistrit RSHTN, GS, Ozonholluese, Gazeve serrë të fluoruara, kimikateve, dhe të dhënat parësore për autorizimin, planet e monitorimit të shkarkimeve të GES-It dhe raportimeve, shkarkimeve;
  - iii. shikon, krijon të dhënat parësore të regjistrit të transferimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme;
  - iv. shikon, krijon të dhënat parësore të regjistrit të eksporteve të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme si dhe tranzit;
  - v. shikon, krijon të dhënat e tij në regjistrin financiar të tarifave;

- vi. shikon, krijon të dhëna parësore ne regjistrin e dëgjësave.
- h) Njësitë e Vetqeverisjes Vendore:
  - Çdo njësi e vetqeverisjes vendore është e lidhur me një përdorues me rolin “NjQV” dhe do të ndërveproje si më poshtë:
    - i. shikon, krijon të dhënat parësore të regjistrin të mbetjeve urbane për çdo qark;
    - ii. shikon, krijon të dhëna parësore ne regjistrin e dëgjësave.
  - i) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave:
    - Drejtoria e përgjithshme e doganave është e lidhur me një përdorues me rolin “Dogana” dhe do të ndërveproje si më poshtë:
      - i. shikon, krijon të dhënat parësore të regjistrin të të dhënave për detyrimin që rrjedh nga legjislacioni në fuqi.
  - j) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:
    - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është e lidhur me një përdorues të rolit “MSH” dhe do të ndërveprojë si më poshtë:
      - i. shikon, krijon të dhënat parësore të regjistrin të të dhënave për detyrimin që rrjedh nga legjislacioni në fuqi.
  - k) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:
    - Ministria e bujqësisë dhe e zhvillimit rural është e lidhur me një përdorues të rolit “MBZHR” dhe do të ndërveprojë si më poshtë:
      - i. shikon, krijon të dhënat parësore të regjistrin të të dhënave për detyrimin që rrjedh nga legjislacioni në fuqi.

8. Palët do të ndërmarrin masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të pa autorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Çdo veprim në sistem lidhur me aksesin, ndryshimin, korrigjimin, përpunimin/përhapjen e të dhënave etj., duhet të lërë gjurmë, me qëllim garantimin e sigurisë dhe të konfidencialitetit të të dhënave.

9. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe drejtoritë rajonale, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Njësitë e Vetqeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**

**Edi RAMA**